

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

**Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:**

**Evelina QIRJAKO - Kryesues**

**Artan ZENELI - Anëtar**

**Medi BICI - Anëtar**

Në datën **18.06.2015** mori në shqyrtim në Dhomën e Këshillimit çështjen administrative që iu përket palëve ndërgjyqëse të mëposhtme:

**PADITËS:**

**Pajtim Jaupaj**

**I PADITUR:**

**Prefektura e Qarkut Vlorë**

**OBJEKTI:**

*Rikthimin në vendin e mëparshëm të punës ose detyrimin e palës së paditur të bëjë pagesën kalimtare në favor të paditësit për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës.*

**BAZA LIGJORE:**

*Neni 146 e vijues i Kodit Punës dhe ligji nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Punonjësve të Policisë së Shtetit”.*

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**, me vendimin nr. 2403, datë 12.11.2010 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të padisë të paditësit **Pajtim Jaupaj**.

Detyrimin e të paditurit Prefektura e Qarkut Vlorë ti paguajë paditësit **Pajtim Jaupaj** shpërblimin e menjëhershëm në masën e dy pagave referuese mujore, si dhe trajtimin financiar me pagesë kalimtare. Rrëzimin e padisë përsa i përket kërimit të paditësit **Pajtim Jaupaj** kundër të paditurit Prefektura e Qarkut Vlorë me objekt rikthimin në vendin e mëparshëm të punës.

**Gjykata e Apelit Vlorë**, me vendimin nr. 886, datë 27.10.2011 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 2403, datë 12.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt: Rrëzimin tërësisht të padisë së paditësit **Pajtim Jaupaj**.

**Kundër vendimit të mësipërm, ka paraqitur rekurs pala paditëse **Pajtim Jaupaj**, i cili kërkon:** Prishjen e vendimit nr. 886, datë 27.10.2011 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2403, datë 12.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë...

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 63/b të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”;

### V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 886, datë 27.10.2011 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2403, datë 12.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë .

*U shpall në Tiranë, me datë 18.06.2015*

**Nr. 11241-00676-00-2012 Regj.Themeltar**

**Nr. 00 - 2015 - 2760 Vendimi (402)**